



Buletini Nëntor 2011 <http://kk.rks-gov.net/malisheve/www.malisheva-komuna.org>



KOMUNA E MALISHEVËS



BULETINI

Nr. 101-Nëntor 2011 ZYRA PËR INFORMIM - <http://kk.rks-gov.net/malisheve/www.malisheva-komuna.org>



Pamje nga investimet në shkollat fillore në Marali dhe Gurbardh



Përmbajtja:

Filloi ndërtimi i Qendrës së Emergjencës.....	3
Kryetari Kilaj i premtton përkrahje HANDIKOS-it në Malishevë	3
IOM-i i kënaqur me implementimin e projekteve në Malishevë.....	4
Vizitohen të riatdhesuarit nga komuna e Malishevës	5
Me 16 nëntor do të bëhet përrurimi i anekseve të shkollave në Marali e Gurbardh	6
Jepen pasaportat e para biometrike në Malishevë	7
Ministrja e Integriteteve përgëzon komunën e Malishevës për punën e bërë për të riintegruarit.....	8
Vlerësohet lartë puna e drejtorisë komunale për Mbrojtje dhe Shpëtim	9
KDI: Në katër vitet e fundit Malisheva ka dyfishuar të hyrat vetjake	12
KPF dha dy rekomandime për mbledhjen e ardhshme të Kuvendit.....	13
Përrurohen investimet në dy projekte të shkollave.....	13
Nga mbledhja e radhës e Këshillit të Drejtorëve	15
Inspektohen punimet në projektet e BE-së në Malishevë.....	15
Kryetari Kilaj priti komandanti i kontingjentit gjerman Dr. Harald Siemon.....	17
Kilaj, Stock dhe Vaughan takojnë personat me aftësi të kufizuara të angazhuar në punë	18
Kryetari Kilaj mori pjesë në zbulimin e shtatores së Nënës Terezë në Gjermani	19
Malisheva shënoi 28 Nëntorin	21
Kuvendi i Komunës mbajti mbledhjen e XXI të radhës	24



Filloi ndërtimi i Qendrës së Emergjencës

Malishevë, 1 nëntor



Sot në Malishevë, është vënë gurëthemeli i Qendrës së Emergjencës. Gurëthemelin e fillimit të ndërtimit të emergjencës, e vunë kryetari i komunës së Malishevës, z. Isni Kilaj, drejtori i Shëndetësisë, z. Skënder Hoti dhe drejtori i QKMF-së, z. Besim Zogaj. Ky projekt, pritet të përfundoj në dhjetor të viti të ardhshëm.

Sipas projektit, qendra e emergjencës, kap një hapësirë prej një mijë metra katrorë, ndërsa kostoja e ndërtimit të saj, është rreth 840 mijë euro. Mundësohet nga Komuna e Malishevës, në bashkëpunim me konzorciumin Control Products & BEN-AF.

Ndërtimi i emergjencës në Malishevë, ka dalë si një nevojë e kohës, për shërbime më efektive shëndetësore, në veçanti të rasteve emergjente, për shkak të largësisë që komuna e Malishevës ka me qendrat e mëdha spitalore.

Kryetari Kilaj i premtonte përkrahje HANDIKOS-it në Malishevë

Malishevë, 2 nëntor

Kryetari i komunës së Malishevës, z. Isni Kilaj ka pritur në takim koordinatoren e shoqatës HANDIKOS, zonjën Feride Hoxha, ku janë diskutuar hallet dhe problemet që e presin këtë shoqatë në vitin që po vjen.



Qëllimi i këtij takimi, kishte të bënte me buxhetin që kjo shoqatë do të përballet përgjatë vitit 2012, ngase tashmë janë larguar disa nga donatorët që e kanë ndihmuar këtë shoqatë, kështu që përveç bisedimeve që i kanë filluar me disa donatorë të tjerë, mbështetje të mëtutjeshme, për të funksionuar HANDIKOS-i, i është kërkuar edhe kryetarit Isni Kilaj.

Z.Hoxha e ka falënderuar maksimalisht kryetarin e Malishevës, për mbështetjen që komuna tash e tetë vite i jep kësaj shoqate, ngase sipas saj “pa përkrahjen tuaj, edhe HANDIKOS-i në Malishevës, do ta kishte fatin e shumë HANDIKOS-ve të tjerë, me mbyllje”. “Unë nuk kam fjalë për të shprehur falënderime ndaj juve, edhe në emër të 600 anëtarëve sa ka kjo shoqatë, ngase mbështetja juaj dhe e donatorëve të tjerë, na ka mbajtur në jetë”, kështu është shprehur zonja Hoxha, ndaj kryetarit të komunës së Malishevës.

Në anën tjetër kryetari Kilaj i ka premtuar përkrahje të pakontestueshme kësaj kategorie në Malishevë, në çfarëdo forme që të jetë e mundur, derisa të zgjidhet statusi i saj në nivel shteti. “Ne jemi të përkushtuar për t’i dalë në ndihmë kësaj kategorie të shoqërisë sonë, derisa të zgjidhet statusi i saj përfundimtar”, tha midis tjerash kryetari Kilaj, duke i premtuar mbështetje të mëtejme zonjës Hoxha-koordinatores së shoqatës HANDIKOS, në Malishevë.

IOM-i i kënaqur me implementimin e projekteve në Malishevë

Malishevë, 4 nëntor

Kryetari i komunës, z.Isni Kilaj, ka pritur sot zyrtarët e lartë të misionit të IOM-it në Kosovës, Jorge Baca Vaughan, shef i këtij misioni dhe Alessia Schiavon, menaxhere e këtij programi, me të cilët kanë biseduar për projektin e Parkut të Gjelbër, që është duke u rregulluar pran liqenit Mirusha. Me këtë rast edhe zyrtarët e IOM-it, u ndanë të kënaqur me ecurinë e projektit.



“Dy janë problemet me të cilat përballemi, me papunësinë dhe mbeturinat, ndërsa qëllimi i këtij projekti është rregullimi i hapësirave të gjelbërua, por edhe zbutja e papunësisë”, ka thënë kryetari Kilaj, i cili paraprakisht i ka falënderuar IOM-in për realizimin e këtij projekti.

Ndërsa shefi i misionit të IOM-it në Kosovë, z.Jorge Baca Vaughan, e ka quajtur “projekt që gjeneron punësimin”.

“Iniciativa për këtë projekt e tregon përkushtimi tuaj për rregullimin këtij parku”, tha z.Vaughan. Ai po ashtu tha se “projekti i komunës së Malishevës, ka qenë njëri prej projekteve më të mira, pasi në tërësi është hartuar në bazë të udhëzimeve dhe kërkesave për të konkurruar në këtë program”.



Në pas, kryetari Kilaj dhe shefi i IOM-it, Vaughan, vizituan punimet në teren, dhe panë nga afër punimet në parkun e gjelbër dhe punëtorët, të cilët janë duke punuar.

Ndërtimi i Parkut të Gjelbër në Mirushë, është financuar nga Komisioni Evropian, ndërsa implementohet nga IOM-i.

Vizitohen të riatdhesuarit nga komuna e Malishevës

Malishevë, 9 nëntor

Me qëllim të njohjes nga afër me kushtet e jetesës së personave të riatdhesuar, zyrtarja për kthim dhe komunitete, znj.Ardita Krasniqi, ka vazhduar me vizitat e saj të drejtpërdrejta, duke u njoftuar nga afër me kushtet në të cilat jetojnë këta persona dhe duke ju ofruar shërbimet që ka kompetencë komuna.



Znj. Krasniqi, sot, ka vizituar, tri familje, në Maxharrë, Shkozë dhe Pagarushë, atë Katsrati, Bytyçi dhe Kryeziu, me ç'rast ka parë nga afër kushtet e banimit të këtyre personave, nga të cilët ka marrë edhe shënimet e nevojshme, pasi paraprakisht këto familje, kanë bërë kërkesë për ndihmë.

Riatdhesimi dhe integrimi i personave të kthyer nga vende të ndryshme të botës, është njëri nga standardet që duhet të plotësoj Republika e Kosovës, për liberalizimin e vizave, por edhe për integritet tjerë në strukturat evropiane. Në këtë fushë edhe komunat kanë obligimet e tyre në lidhje me integrimin e personave të kthyer, duke ju ofruar shërbimet komunale, si: dokumentacionin e duhur, shërbimet shëndetësore, pastaj socializmi i tyre në shoqëri, arsimim, etj.

Me 16 nëntor do të bëhet përrurimi i anekseve të shkollave në Marali e Gurbardh

Malishevë, 9 nëntor

Kryetari i komunës së Malishevës, ka pritur në takim përfaqësuesin e USAID-it, z. Pieter Devries, me ç'rast janë diskutuar punët përgatitore për përrurimin e dy anekseve të shkollave "Ruzhdi Xhyliqi", në Marali dhe asaj "Eqrem Çabej", në Gurbardh.

Tashmë kanë përfunduar dy ankese në shkollat e lartpërmendura, si donacion i përbashkët midis USAID-it dhe komunës së Malishevës, dhe të cilat do të përrurohen të mërkurën, më datë 16 nëntor 2011.



Kryetari i komunës së Malishevës, z. Isni Kilaj, është shprehur i kënaqur me këto investime dhe njëkohësisht ka falënderuar USAID-in, për këtë investim të përbashkët.

Jepen pasaportat e para biometrike në Malishevë

Malishevë, 11 nëntor



Nga dita e sotme, edhe në komunën e Malishevës, ka filluar dhënia e pasaportave biometrike. Në një ceremoni solemne të organizuar në ambientet e Qendrës së Regjistrimit Civil (QRC), Kryetari i Komunës së Malishevës, z. Isni Kilaj, i ka dhënë dy pasaportat e para biometrike, për qytetarët Tefik Ulluri dhe Hajrë Kastrati.

Dhënia e pasaportave biometrike, është edhe një hap më shumë në përmbushjen e standardeve drejt integriteteve evropiane dhe liberalizimit të vizave, është vlerësuar në këtë ceremoni. “Ky lloj i pasaportave, kanë një siguri të lartë dhe është konformë standardeve evropiane”, tha Sheremet Hoti, përgjegjës QRC-së në Malishevë.

Hoti, ka informuar se, të gjithë ata që dëshirojnë të aplikojnë për tu pajisur me pasaportë biometrike, mund ta bëjnë këtë çdo ditë pune, si dhe ka sqaruar se procedura e nxjerrjes së pasaportës është e njëjtë nga ajo që ka qenë deri më tash.



Ministrja e Integrimeve përgëzon komunën e Malishevës për punën e bërë për të riintegruarit

Malishevë, 14 nëntor



Ministrja e Integrimeve, znj. Vlora Çitaku, ka vizituar sot, komunën e Malishevës, ku është pritur nga kryetari Isni Kilaj, dhe zyrtarë të tjerë komunal.

Qëllimi i vizitës ishte, përgëzimi për punën e bërë nga komuna e Malishevës, në lidhje me riintegrimin e qytetarëve të kthyer.

“Kam ardhur këtu për t’ju përgëzuar për punën që e keni bërë deri më tani, dhe ndërkohë do të kërkoj që komunat tjera ta marrin si shembull Malishevën, në lidhje me këtë çështje”. “Unë jam e njoftuar që keni bërë informimin e duhur për qytetarët e kthyer edhe përmes medieve lokale dhe njoftimeve të ndryshme, për t’i riintegruar ata në shoqërinë e vendit”. Kështu është shprehur znj.Çitaku, e cila njëkohësisht ka falënderuar kryetarin e komunës së Malishevës. Z. Isni Kilaj dhe stafin e tij, për angazhimin dhe bashkëpunimin treguar në këtë aspekt.

Me këtë rast kryetari i ka dorëzuar ministres, listën me emrat e njëzet e tre (23) të kthyerve dhe e ka njoftuar atë, për vizitën që iu bëhet këtyre personave në vazhdimësi, nga zyrtarja për kthim në këtë komunë, Ardita Krasniqi.



Në fund ministria e Integriteteve ka kërkuar që të apelohej tek qytetarët, për të mos kërkuar azil në botën e jashtme, ngase një gjë e tillë është e papranueshme për shtetasit e Republikës së Kosovës, nga vendet e tjera.

Vlerësohet lartë puna e drejtorisë komunale për Mbrojtje dhe Shpëtim

Malishevë, 14 nëntor

Kryetari i komunës së Malishevës, z.Isni Kilaj, ka pritur sot koordinatoren e Qendrës Operative Emergjente Rajonale (QOER) 112 në Prizren, z.Halil Blakaj, me të cilin kanë biseduar për punën e drejtorisë komunale për Mbrojtje dhe Shpëtim, ku është vlerësuar lartë puna e kësaj drejtorie.



Qëllimi i këtij takimi, ishte njoftimi i kryetarit dhe drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, me agjendën e trajnimeve profesionale për mbrojtje dhe shpëtim në menaxhimin e emergjencave, për vitin e 2012.

Me këtë rast kryetari i komunës së Malishevës u shpreh të jetë i kënaqur me punën e kësaj drejtorie. “Unë janë shumë i kënaqur me këtë drejtori, pasi janë në nivelin më të mirë të mundshëm, si në intervenimet dhe menaxhimet e zjarreve, ashtu edhe në furnizimin me ujë të qytetarëve, por edhe organizime tjera, e deri te ndihma e dhënë ndaj komunave të tjera”, tha z. Kilaj.

“Drejtorja për Mbrojtje dhe Shpëtim e Malishevës, është e organizuar më së miri konform ligjit”, tha koordinatori Blakaj.



Në këtë takim, u diskutua edhe për çështje tjera që lidhen me këtë fushë; mundësisë që të ndihmohet me shumë shërbimi i zjarrfikësve, për shkak të territorit të hapur që ka komuna e Malishevës, si dhe është diskutuar për nevojën e decentralizimit më të madh të këtij shërbimi.

U mbajt mbledhje komemorativ me rastin e vdekjes së veprimtarit Skënder Shala

Malishevë, 16 nëntor

Me rastin e vdekjes së veprimtarit të çështjes kombëtare, Skënder Shala (1959-2011), sot në Malishevë, u mbajt një mbledhje komemorativ, ku morën pjesë udhëheqës të institucioneve qendrore dhe komunale, bashkëluftëtar e bashkëveprimtar, dhe familjar e të afërm të Skënder Hafir Shalës.

Për jetën dhe veprimtarin e tij, folën Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Isni Kilaj, zëvendësministri në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), z.Fatmir Shurdhaj, pastaj bashkëluftëtar të tij, si dhe përfaqësues të OVL të UÇK-së, dega në Malishevë.



Në këtë mbledhje komemorativ, u çmua lartë veprimtari e tij në mërgim, angazhimi i tij personal dhe familjar në luftën për liri, si dhe u sollën evokime nga bashkëveprimtarë e Skënder Shalës, i cili vdiq të hënë, pas një sëmundje të rëndë.

Në emër të Qeverisë të Republikës së Kosovës dhe kryeministrit z.Hashim Thaçi, familjes i shprehi ngushëllime, zv/ministri i MPMS, z.Fatmir Shurdhaj, ndërsa evokimet nga veprimtaria e Skënder Shalës, solli Ajet Kastrati.



Skënder Shala, la pas vetes, bashkëshorten dhe katër fëmijë, ndërsa varrimi bëhet në ora 14 në varrezat e fshatit të tij të lindjes, në Kleçkë.

Fjalimin kryesor në këtë mbledhje, e mbajti Kryetari i Komunës, z.Isni Kilaj. Në vazhdim teksti i plotë i fjalës së rastit të kryetarit Kilaj:

Kryetari i Komunës së Malishevës, Isni Kilaj

Datë: 16 nëntor 2011

Fjalë rasti në akademinë, me rastin e vdekjes së Skënder Shalës

E nderuara familje e Skënder Shalës, të nderuara familje të dëshmorëve, invalid e veteran të UÇK-së, të dashur pjesëmarrës në këtë akademi me rastin e ndarjes nga jeta, të veprimtarit të dalluar të çështjes kombëtare, të militantit e patriotit, të veprimtarit e luftëtarit për liri, të vllahut të dëshmorit të kombit Sadikut, Skënder Shala. Jam i nderuar që më është dhënë rasti të paraqes fjalën time për Skënderin. Përmes këtij fjalimi dua të shpreh nderimet më të larta dhe të singerta për Skënderin, për jetën dhe veprimtarinë e tij. Skenda i takon njëres nga familjet më emblematike të Malishevës, Lipjanit e Kosovës në përgjithësi. Veprimtaria patriotike e Skënderit në Zvicër dhe e vëllezërve të tij, do të bëjnë që shqiptarët të edukohen me frymën e lirisë dhe atdheadashurisë, që fryma pacifiste të zëvendësohej me luftën për liri, me lindjen, rriten dhe fitoren e UÇK-së në luftën e saj titanike. Vëllezërit e Skënderit dhe familja e tij, u bënë fole, ku u lind dhe u zhvillua njëra nga Njësitë Operative më të suksesshme të luftës, Çeliku-Brigada 121 e UÇK-së. Ajo shtëpi do të jetonte me luftën dhe popullin e tij, deri në çlirimin të vendit. Nën atë e familjes Shala, do të gatuanin bukën për ushtarët pa ndërrime e pushime, ditën e natën, ajo shtëpi e familjes së Skëndes, do të strehonte qindra e mijëra luftëtar, do të mbante e ushqente qindra luftëtar, ushtarë e dëshmorë, qindra të plagosur, emra të mëdhenj të luftës, takime të rëndësishme për luftën e fatin tonë. Aty do kalonte një pjesë të jetës me uniformë Tahir Sinani, Ismet Jashari, Habib Zogaj, Nuhi Mazrreku, e shumë të tjerë. Ishte shtëpi e të gjithë atyre që e donin lirinë. Ajo familje e Skënderit, nuk mjaftonte me shërbimet që i bënte luftës, por ajo do u jepte armët, burrave e ata do luftonin me vëllezërit e pushkës, e Sadiku do binte dëshmorë i kombit, për të mos vdekur kurrë. Luftën do e vazhdonin vëllezërit deri në fitoren e lirisë. Dhe lufta megjithatë do vazhdonte për familje e Skënderit, e sfidat e shumta do e përcjellin deri më sot. Skënderin vdekja e gjeti me vëllezër të burgosur, sepse kështu desh një dorë e zezë, që shkroi një ditar tradhtie e njolle të zezë. Por ajo nuk do e ulë vlerën që ka familja e Skëndes, Sabitit, Fatmirit, Naserëve e Refkiut, dhe të gjithë atyre që sot privohen nga liria për mëkatet që bënë; se luftuan për liri.



Skenda e dinte këtë. Të mëdhenjve, të fortëve, atdhetarëve, gjithmonë u bie barrë e rëndë. Por ata gjithmonë fitojnë.

Skënderi do e kujtojmë për buzëqeshjen e tij të ëmbël, për burrërinë e rrallë, për trimërinë e pashoqe, për krenarinë dhe guximin, për çiltërsinë qiellore. Jeta deshi që ët jetë e tillë. Ai shkoi para kohe, por na e la një familje emblemë, një vepër të jashtëzakonshme, një shembull dinjiteti e krenarie.

Familja, shokët, bashkëlufëtaret, bashkëveprimtarët, që ët gjithë ne ndjehemi krenar që të patëm i dashur Skënder.

Lavdi jetës dhe veprës së Skënder Shalës, Lavdi të gjithë dëshmorëve të kombit.

KDI: Në katër vitet e fundit Malisheva ka dyfishuar të hyrat vetjake

Malishevë, 17 nëntor

Në publikimin e fundit të Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), për “Përparimi i pjesëmarrjes qytetare në bërjen dhe realizimin e buxhetit komunal”, komuna e Malishevës, cilësohet më e mira në gjenerimin e të hyrave vetjake, në katër vitet e fundit.

“Bazuar në të dhënat e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm (dhe duke përdor formulën të hyrat totale / numri i popullsisë) gjatë katër (4) viteve të fundit kemi një ngritje të të hyrave të përgjithshme në komuna të regjionit të Prizrenit për kokë banori”, thuhet mes tjerash në raportin e KDI-së..

“Krahasuar me vitet paraprake vetëm komuna e Malishevës kishte një ngritje të theksuar (dyfishim) në gjenerimin e të hyrave vetjake”, thuhet më tej në raportin e KDI-së.



KPF dha dy rekomandime për mbledhjen e ardhshme të Kuvendit

Malishevë, 17 nëntor



Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF), i kryesuar nga kryesuesi i Kuvendit Komunal, z.Ragip Begaj, ka mbajtur sot mbledhjen e pesëmbëdhjetë të radhës, me ç'rast ka dhënë dy rekomandime për mbledhjen e ardhshme të Kuvendit të Komunës së Malishevës.

Në këtë mbledhje, është shqyrtuar dhe është rekomanduar për Kuvend, lista e projekteve kapitale për vitin 2012, prioritetet përtej buxhetit komunal për vitin 2012, e propozuar nga Kryetari i Komunës, z.Isni Kilaj.

Ndërsa rekomandimi i dytë, ishte raporti i ankesave për tatimin në pronë, për vitin 2011, i përpiluar nga bordi për shqyrtimin e ankesave. Për këtë raport, sqarime para anëtarëve të KPF-së, ka dhënë kryetari i këtij bordi, z.Gani Bahtjaraj.

Po ashtu KPF, në pamundësi të realizimit të kërkesave të qytetarëve, të cilat kanë të bëjnë kryesisht për mjete financiare, i ka refuzuar ato.

Përurohen investimet në dy projekte të shkollave

Malishevë, 18 nëntor



Sot janë përruar dy projekte/aneke të shkollave “Ruzhdi Xhyliqi” në Marali dhe rinovimi i shkollës “Eqrem Çabej” në Gurbardh. Këto janë dy investime si bashkëpunim i Komunës së Malishevës dhe USAID-it. Përrimin e këtyre dy investimeve, e kanë bërë Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Isni Kilaj, përfaqësuesi i USAID-it, z.Andy Boegel, drejtori i Drejtorisë Arsimit Isuf Morina dhe drejtorët e shkollave në Marali dhe Gurbardh, z.Refki

Hoxha, përkatësisht z.Sabit Berisha.

Në këto dy ceremoni, kryetari i Malishevës, z.Isni Kilaj, ka falënderuar USAID-in, për kontributin e tyre në përgjithësi dhe në veçanti për investimet në fushën e arsimit. “Falënderojmë USAID-in dhe popullin amerikan për mbështetjen që po i jep popullit shqiptar”, tha Kilaj. “Popujt që na duan më shumti, investojnë në shkolla”, tha në fund Kilaj, i cili i ka uruar nxënësit, arsimtarët dhe banorët e fshatrave Marali e Gurbardh.

“USAID-i është këtu që ta ndihmoj popullin e Kosovës të ec përpara dhe kjo më së miri bëhet përmes investimit në shkolla dhe arsim”, ka thënë mes tjerash, zyrtari i lartë i USAID-it, Andy Boegel.

Kosto e ndërtimit të aneksit të shkollës në Marali, është 183 596 €, ku USAID-i ka investuar 94 073 €, ndërsa Komuna e Malishevës, ka investuar 89 523€.

Kurse rinovimi i shkollës në Gurbardh, ka kushtuar 106 631 €, ku komuna e Malishevës, ka investuar 28 240 €, kurse USAID-i 78 391 €.



Nga mbledhja e radhës e Këshillit të Drejtorëve

Malishevë, 21 nëntor

Sot, në mbledhjen e radhës, të Këshillit të Drejtorëve të qeverisë së Malishevës, e udhëhequr nga Kryetari i Komunës, z.Ismi Kilaj, e ku diskutuan disa çështje që kanë të bëjnë me përfundimin e vitit, si fillimi i përgatitjes së raporteve të punës, përfundimi i punimeve të papërfunduara dhe të tjera.



“Shumë projekte janë realizuar gjatë këtij dhe disa të tjera janë në realizimin e sipër, e i fundit është rruga e fshatit Rud”, tha kryetari Kilaj, duke folur për punën e qeverisë komunale gjatë këtij viti. Kryetari Kilaj, po ashtu tha se “të gjitha shkollat janë të furnizuara mirë me lëndë djegëse për ngrohje dhe nuk ka probleme në këtë drejtim”.

Ndërsa, drejtori për bujqësi, Sinan Kryeziu, njoftoi se “për subvencionim të fermerëve, për mbjellje të grurit, kanë aplikuar rreth 650 fermer, ndërsa në të gjithë sektorët e bujqësisë, përfshi edhe subvencionet për bagëti, pritet që shuma e përgjithshme për komunën Malishevën të jetë rreth gjysmë milion euro”.

Në këtë mbledhje, u diskutua edhe për përgatitjet për shënimin e festës së 28 Nëntorit, ku do të organizohen disa aktivitete kulturore dhe sportive, pastaj edhe përgatitjet për fundvit.

Inspektohen punimet në projektet e BE-së në Malishevë

Malishevë, 22 nëntor



Zyrtarët e lartë të Zyrës Ndërlidhëse të Komisionit Evropian në Kosovë, të programit “Beautiful Kosovo”, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), përfaqësues të IOM-it dhe DRC-së, të shoqëruar nga kryetari i komunës, z.Ismi Kilaj, kanë parë nga afër punimet në projektet e Bashkimit Evropian (BE), që po realizohen në Mirushë dhe Dragobil, ku janë ndarë të kënaqur me ecurinë e tyre.

Kryetari Kilaj, më këtë rast i ka falënderuar zyrtarët nga Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian në Kosovë, për financimin e këtyre projekteve me shumë rëndësi për këtë komunë.

Zyrtarja e ngarkuar për menaxhimin e projektit Beautiful Kosovo, pranë zyrës ndërlidhëse të Komisionit Evropian, Emilia Gargallo Gonzalez, është shprehur e kënaqur me ecurinë e dy projekteve dhe ka lavdëruar Komunën e Malishevës, për idenë e projektit për Parkun e Gjelbër në Mirushë, si dhe ka uruar uruar shkollën “E.Duraku” në Dragobil, për projektin të cilin e kishin fituar në garën e Komision Evropian.

Zyrtarja Gonzalez, ishte e shoqëruar nga Alessia Schiavon, pastaj Lulzim Karaxha nga MPMS-së, dhe zyrtarët tjerë nga IOM dhe DRC. Këto dy projekte janë projekte të Bashkimit Evropian, menaxhohen nga Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian në Kosovë dhe implemtohen nga IOM-i dhe DRC.

Ajo që është më e rëndësishme, në projektin e Parkut të Gjelbër në Mirushë, është sepse, janë punësuar persona me nevojë të veçanta (aftësi të kufizuara), nga Handikos-i dhe shoqata e të verbërve, përmes zyrës për punësim në Malishevës dhe MPMS-ës.

Projekti i rregullimit të Parkut të Gjelbër në afërsi të liqenit në Mirushë, ka një shumë prej rreth 100 mijë euro dhe janë të angazhuar afro 50 punëtor, ndërsa projekti i hapësirë së gjelbër dhe hapësirës



sportive në shkollën “Emin Duraku” në Dragobil, kap shumë prej rreth 56 mijë euro. Të dy këto projekte janë në përfundim e sipër.

Kryetari Kilaj priti komandanti i kontingjentit gjerman Dr. Harald Siemon

Malishevë, 24 nëntor

Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ismi Kilaj, ka pritur sot komandantin e kontingjentit gjerman të KFOR-it, kolonel Dr. Harald Siemon, me të cilin ka biseduar për rrjedhat e përgjithshme në Malishevë.

Kilaj e ka falënderuar kolonelin Siemon për vizitën e tij në Malishevë, si dhe për ndihmën e vazhdueshme të KFOR-it gjerman dhe popullit gjerman për Malishevën dhe për Kosovën në përgjithësi. “Në luftën e fundit, ndihma gjermane ka qenë shumë e madhe dhe ne ju jemi mirënjohës përgjithmonë”, ka thënë kryetari Kilaj.



“Ky kontribut i Gjermanisë ka bërë që sot populli shqiptar i Kosovës, të bëhet si pjesë e Gjermanisë”, ka thënë Kilaj, duke e falënderuar komandantin e kontingjentit gjerman të KFOR-it, kolonelin Siemon.

Në këtë takim kryetari ka kërkuar që “KFOR-i të vazhdojë të jep kontributin e tij, në aspektin e sigurisë së përgjithshme në Kosovë, e sidomos në veriun e vendit”.

Në anën tjetër, koloneli Siemon e ka falënderuar kryetarin Kilaj, për kohën e ndarë për të takuar dhe shprehur kënaqësinë e tij për këtë takim.



Kryetari Kilaj dhe koloneli Siemon, kanë biseduar për rrjedhat e përgjithshme në Malishevë dhe në vend, si dhe për mundësitë e zhvillimit ekonomik të Malishevës, e po ashtu edhe për mundësitë që autostrada do të mund ti jepte Malishevës.

Për këtë çështje, z. Kilaj, tha se “autostrada ka rëndësi në zhvillimin e Malishevës, duke filluar nga ndërtimi i saj, në pjesën e Malishevës, e që do të punësohen qindra punëtor nga Malisheva, por edhe pas ndërtimit ndihmon mjaft”.

Kilaj, Stock dhe Vaughan takojnë personat me aftësi të kufizuara të angazhuar në punë

Malishevë, 24 nëntor



Kryetari i Komunës së Malishevës, z. Isni Kilaj, bashkë me shefin e operacioneve në Zyrën Ndërlidhëse të Këshillit Evropian (ZNKE) në Kosovë, z. Christof Stock dhe shefi i IOM-it në Kosovë, z. Jorge Baca Vaughan, kanë vizituar sot personat me aftësi të kufizuara, të angazhuar në punë, në një projekt të përbashkët që financohet nga Bashkimi Evropian.

Kjo vizitë, kishte për qëllim jo vetëm inspektimin e punimeve në Parkun e Gjellbër në Mirushë, por edhe takimin me persona me nevojë të veçanta të angazhuar në punimet për ndërtimin këtij parku dhe kjo është bërë në prag të ditës ndërkombëtare të personave me aftësi të kufizuara.



Ata kanë shprehur kënaqësinë e tyre, për angazhimin e këtyre personave në punë, duke dhënë një shembull të mirë për përfshirjen e tyre, jo vetëm në punë, por edhe duke e bërë këtë kategori të ndihen pjesë e shoqërisë, pasi edhe këta mund të punojnë, të shkollohen dhe të kryejnë çdo aktivitetet, si gjithë tjerët.

Ndërsa, sa i përket projektit për ndërtimi e Parkut të Gjelbër, të gjithë zyrtarët e lartë të ZNKE-së dhe IOM-it, u shprehën të kënaqur me idenë e ndërtimit të këtij parku dhe kanë inkurajuar komunën, që të vazhdoj me projekte të tilla.

Ndërsa, kryetari Kialj, duke i falënderuar për vizitën dhe për financimin e këtij projekti, ka thënë se “ky projekt, ka dy qëllime kryesore, pasi përveç krijimit të hapësirave të gjelbra, këtu gjenerohet hapja e vende të reja të punës dhe largimi i mbeturinave, pasi në Kosovë, mbeturinat dhe papunësia, janë dy problemet kryesore me të cilat përballemi”.

Në fund, kryetari Kilaj, bashkë me dy zyrtarët e lartë të ZNKE-së dhe IOM-it, kanë mbjellë drunj në Parkun e Gjelbër në Mirushë.

Kryetari Kilaj mori pjesë në zbulimin e shtatores së Nënës Terezë në Gjermani

Sundern/Malishevë, 26 nëntor

Kryetari i Komunës së Malishevës, z. Isni Kilaj, me ftesë të kryetarit të Komunës së Sundern-it në Gjermani, z. Detlef Lins, mori pjesë në ceremoninë e zbulimin e shtatores së Nënës Terezë, në këtë qytet, ndërsa vizitën e tij e shfrytëzoi edhe për tu takuar me bashkatdhetarët tanë që jetojnë dhe punojnë në Gjermani.



Kryetari Kilaj, ishte i shoqëruar nga nënkryetari i komunës, z.Rexhep Mazreku, ndërsa në këtë ceremoni, ishin të ftuar edhe zv/ministri për kulturë në Qeverinë e Republikës së Kosovës, z. Hajdin Abazi, pastaj Ambasadori z.Vilson Mirdita, Atasheu i Republikës së Kosovës në Frankfurt, z. Astrit Zemaj dhe bashkatdhetar të shumtë në Gjermani.



Kryetari Kilaj, i ka falënderuar për ftesën, komunën e Sundernit, si dhe për vendosjen e shtatores së humanistes së madhe shqiptare, Nënës Terezë.

Në vazhdim, fjalimi i kryetarit Kilaj, i mbajtur në këtë ceremoni:

Republika e Kosovës

Komuna e Malishevës

Kryetari, Isni Kilaj

Datë: 26.11.2011

Fjalë rasti, ne zbulimin e shtatores së “Nënë Terezës” në Sundern të Gjermanisë

I nderuar kryetar i komunës së Sundernit, z.Linds, i nderuar kryetar i qytetit të Sundernit, të nderuar përfaqësues të Kishës Katolike dhe Evangjeliste, i nderuar zëvendësministër Hajdin Abazi, i nderuar konsull i Republikës së Kosovës në Frankfurt, z.Zemaj, të dashur qytetar të Sundernit, bashkatdhetarë dhe bashkëvendës të mi të Malishevës.

Sot para shtatores së Nënë Terezës dhe para jush, ndihem krenar që jam shqiptar dhe që jam qytetar i Evropës në mesin e popullit të çmuar e vëlla gjerman. Shqiptarët kanë tre personalitete të çmuara të historisë së tyre.



-Skënderbeun, i cili për 25 vite, nga viti 1443, e deri më 1468, mbrojti krishterimin dhe qytetërimin evropian nga dyndjet dhe pushtimet e Osmanëve.

-ka Nënë Tereze, të cilën e zgjodhi Zoti që përmes shpirtit të shenjtë të saj, të u sjell njerëzimit mesazhin për paqe, dashuri, mëshirë, zemër e bujari njerëzore.

- dhe të tretin personalitet me përmasa biblike, kemi Adem Jasharin, i cili u tregoi njerëzve në kohën tonë. Dashurinë për atdheun, trimërinë, heroizmin, sakrificën për të fituar lirinë.

Të dashur pjesëmarrës, Kryetari i Komunës së Sundernit, Kuvendi i qytetit, qytetarët e këtij vendi, sot edhe njëherë po tregojnë supremacinë e tyre në çmuarjen e vlerave universale, po tregojnë madhështinë e tyre si popull e kulturë, po tregojnë besimin dhe respektin e tyre që kanë për popullin shqiptar dhe vlerat universale në vendosjen e kësaj shtatoreje të Nënës Terezë.

E unë i falënderoj nga zemra, për të ua kujtuar edhe njëherë se Kosova dhe Shqiptarët kanë ideal popullin gjerman, të cilët janë përjetësuar në historinë tonë dhe kulturën botërore përgjithësisht.

Ju faleminderit Kryetar i Komunës së Sundernit,

Ju faleminderit popull gjerman.

Malisheva shënoi 28 Nëntorin

Malishevë, 28 Nëntor



Me rastin e 28 Nëntorit, Ditës së Flamurit, datëlindjes së Komandantit Legjendar Adem Jashari dhe daljes së parë publike të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të thirrur nga Kryetari i Komunës z.Isni Kilaj, Kuvendi i Komunës së Malishevës, ka mbajtur një seancë solemne.

Përveç kryetari Kilaj, fjalë rasti dhe urime për festat e 28 Nëntorit, kanë dërguar edhe kryesuesi i KK-së, z.Ragip Begaj, shefi i grupit të këshilltarëve të PDK-së, Enver Hoti, ai i LDK-së, z.Januz Kastrati, pastaj z.Hafir Rexha nga AKR dhe Milazim Rudi nga LDD-ja. Po ashtu një fjalë rasti ka mbajtur edhe z.Enver Hoti, nga OVL e UÇK-së, dega në Malishevë.

Pas seancës solemne, janë bërë nderime pran shtatores së Komandantit Legjendar Adem Jashari në Malishevë, pastaj homazhe te varrezat e dëshmorëve në Prekaz, Kleçkë dhe Malishevë.



Në Prekaz, kryetari Kilaj, i shoqëruar nga këshilltarët komunal të të gjitha grupeve, pastaj OVL e UÇK-së dhe shoqata tjera, janë pritur në odën e Jasharajve, ku janë takuar me Murat Jasharin dhe kanë shkëmbyer urimet për festat e 28 Nëntorit.

Ndërsa gjatë ditës janë mbajtur edhe aktivitete tjera sportive dhe kulturore, si turnirë të ndryshme dhe koncerte.

Në vazhdim fjalimi i Kryetarit të Komunës së Malishevës, mbajtur në seancën solemne të KK të Malishevës:

Republika e Kosovës

Komuna e Malishevës

Kryetari, Isni Kilaj



Datë: 28 Nëntor 2011

Fjalë rasti në Mbledhjen e Solemne të Kuvendit të Komunës në Malishevë, me rastin e festave të Nëntorit

I nderuar Kryesues i Kuvendit, Këshilltar, shoqata të dala nga Lufta e UÇK-së, veteran, ish Kryetar të Komunës sonë, përfaqësues të institucioneve vendore, veteran të luftës dhe Ju të pranishëm, më lejoni që të ju uroj festat më të mëdha të shqiptarëve në përgjithësi, sepse:

-28 Nëntori i vitit 1443, Gjergj Kastrioti Skënderbeu mori kalanë e Krujës, e cila ishte kryeqytet i Principatës së Kastriotëve, ngriti flamurin dhe shpalli pavarësinë nga sulltani,

-28 Nëntorin e vitit 1912, kur mendjendrituri Ismail Bej Vlora, në çastet e fundit para se të ndaheshin trojet shqiptare nga pushteti sllav, ngriti flamurin në Vlorë dhe shpëtoi një pjesë të trungut shqiptar për të e pasur qëllim, ideal, mbështetje, forcë e shpirt për dhjetëra e qindra gjenerata të mëvonshme, ku si qëllim patën lirinë dhe bashkimin për të gjithë kombin dhe trojet shqiptare.

-28 Nëntor e vitit 1955 në Prekazin legjendar, lindi kryeheroi ynë Adem Jashari, i cili do t ndryshonte historinë, jo vetëm të shqiptarëve, por edhe të gjithë Evropës. Ai do shndërrohet në Komandant Legjendar në Luftën e UÇK-së.

-28 Nëntor 1997 në Llaushë të Skënderajt, djalëria shqiptare doli publikisht dhe hoqi maskat për të shpallur krijimin dhe veprimet e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. UÇK-ja do vazhdoi luftën deri në çlirimin e definitiv të vendit. Kosova do të jepte mbi tre mijë dëshmorë të kombit, E lirinë do e fitonte më 17 Shkurt 2008, kur Hashim Thaçi, Kryeministër i Kosovës, lexoi dhe shpalli Kosovën e Pavarur dhe Sovrane.

Të dashur pjesëmarrës, kjo datë historike, ishte fati i mbarë për kombin tonë. Në këtë datë u sendërtuan kërkesat, përpjekjet, sakrifica dhe lufta jonë për liri. Ata që e bënë, që këto data të shënohen, përjetësuan veten e tyre dhe kombin tonë. Historianët shkruan mijëra libra histori e ngjarjes, thurën romane e shkruan këngë lavdie e heroizmi. Ne të gjallët u frymëzuam nga këto vepra. Krenaria është



pjesë e kulturës sonë. Gjatë viteve që do të vijnë, do të përcjellim të gjallët që mbetën pas luftës. Për ta historia do të shkruhet – kontributi do të çmohet. Gjeneratat që do të vijnë, do të kenë me çfarë të krenohen. Ne kemi një histori të çmuar, të pasur dhe të lavdishme.

Të dashur të pranishëm, fjalimin tim po e përmbyll me fjalët e Plakut të urtë Ismail Qemalit, ”.....Se një popull që fle vdes...” dhe ne, nuk e kemi ndërmend të vdesim, ne do rrimë zgjuar, e do punojmë, do të forcojmë shtetet tona shqiptare dhe do të synojmë Bashkimin Kombëtar, ashtu siç bënë gjermanët, ashtu siç deshën rilindësit tanë, ashtu siç deshën dëshmorët e kombit, ashtu siç dëshirojmë ne të gjallët....

Lavdi të gjithë Dëshmorëve të Kombit,

Rroftë Populli Shqiptarë.

Kuvendi i Komunës mbajti mbledhjen e XXI të radhës

Malishevë, 30 nëntor



Kuvendi i Komunës së Malishevës, ka mbajtur seancën e njëzetën të radhës, ku është miratuar propozimi i kryetarit të komunës, për projektet kapitale, prioritetet jashtë buxhetit komunal, si dhe është miratuar formimi i komisionit për hartimin punës së Kuvendit.

Me disa propozime nga ana e këshilltarëve në Asambleen Komunale, është miratuar propozimi i Kryetarit të Komunës, z.Isni Kilaj, për investimet kapitale, projekte kapitale, jashtë buxhetit komunal, për vitin 2012.



Ndërsa, para këshilltarëve komunal, udhëheqësi i Bordit për Shqyrtimin e Ankesave, për tatim në pronë, z.Gani Bahtjaraj, ka prezantuar raportin e punës në shqyrtimin e ankesave, ku sipas tij, gjatë vitit 2011, janë paraqitur njëmbëdhjetë ankesa, të cilat janë shqyrtuar nga ky bord.

Në fund, me propozim të kryesuesit të Kuvendit, z.Ragip Begaj, është miratuar formimi i komisionit të punës, për hartimin e planit të punës së Kuvendit, si dhe me shumicë votash, u miratua numri i anëtarëve të këtij komisioni, i cili do të përbëhet nga nëntë anëtar.